



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 18-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.04.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Valon Pacolli, DEZH
5. Shkelzen Hajdini, DSH
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Rexhep Rexhepi, DBP
9. Rasim Hasani, DA
10. Safete Amerrlahu, DGJK
11. Imri Smeteishti, DUMM
12. Burim Rrustemi, DSHPMSH
13. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2023.
3. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Momoramdum, bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “Qatar Charily”).
4. Propozim Vendimi për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për Hyrje në bashkëpunim ndër-komunal.
5. Propozim Rregullore për orarin e punës të veprimtarive ekonomike në teritorin e Komunës së Lipjanit.
6. Propozim Vendimi për zëvendësimin e anëtarës së Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2022-2023.
7. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Vendimi për zëvendësimin e anëtarës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- KKSBB-së.
9. Informatë për raportin vjetor financiar 2022, të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave KPM “Pastrimi” Sh.A.

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Me që diskutime tjera nuk pati, kryesuesi e hodhi në votim rendi i ditës i kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Albiona Tasholli, tha se kam një çështje për ta ngritur, ajo ka të bëjë me kujdesin paleativ, pasi qe kujdesi paleativ ka rendësi shumë të madhe për jetën e qytetarit. Prandaj unë sot propozoj qe të bëhet zgjerimi i këtij ekipi nga dy persona në katër. Po ashtu edhe të bëhet organizimi i tyre që të punojnë në dy orare pune. Me këtë do te rriten shërbimet dhe më shumë.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se respektoni rregulloren e punës, mos ndërhyjni kur flet dikush, respektoni njëri tjetrin, mos flisni nga vendi.

Arsim Jashari, tha se kam disa kërkesa dhe disa pyetje, Pyetja e parë është nga banorët e rrugës “Ymer Ukshini” në fshatin Gadime, për rrugën e tyre e cila është e pa shtruar dhe po kërkojnë të rregullohet. E dyta ka të bëjë me banorët e fshatit Banullë për rrugën “Livadhet e Thata”, ku kërkojnë që të rregullohet trotuari . E treta për rrugën “Kruja” në fshatin Gllgovc ku banorët e kësaj rruge kërkojnë të bëhet intervenohet në kanalizim pasi që po ka telashe të mëdha për ata banorë. Tjetra ka të bëjë me KF Ulpiana, për vendosjen e reflektorëve në stadium. Pasi qe janë shumë te nevojshme dhe ndihmesë shumë e madhe për klubet sportive. Kërkesa e fundit është nga banorët e fshatrave Kraishtë, Bregu i Zi, Vragovc dhe Godanc të cilën e kundërshtojnë groposjen e kafshëve ne pronën publike e ndarë në vitin 2018 nga kuvendi, ju bëjnë thirrje që ta anuloni këtë vendim dhe të gjinden një vend tjetër. Dhe e fundit falja e tatimit në pronë nga ana e Qeverisë sa do të ndikojë në të ardhurat e komunës. E kam një propozim që të ketë një kampanjë nga të gjithë për ndalimin e hedhjes së mbeturinave ne vendet e ndaluara. Dhe e fundit e kam një pyetje që të jetë një vendim për caktimin e varrezave qe te jetë nje distancë sa më larg nga shtepitë te jenë varrezat.

Alban Salihu, tha se kam dy çështje për t'i ngritur, e para KESKO ka intrevenu por e ka dëmtuar rrugën kërkoj që ajo pjesë të rregullohet, ose ti bëhet presion kompanisë qe ta rregullon atë pjesë. Dhe e dyta komuna e ka pas marrë përsipër që

të ju paguhen faturat e mbeturinave rasteve sociale ,mirëpo sipas qytetarëve ato nuk po bëhen si ka mbet puna me këto fatura?

Egzona Bytyqi, tha se para disa dite Ministria e Shëndetësisë ka miratuar ligjin ku secili qytetar ka të drejtë me zgjedh mjekun e vet familjar. Ky projekt do te jetë ne 4 komuna. Ai ka marr komuna jonë direktivat përkatëse. E dyta ka të bëjë me DSHP, për zhurmën e madhe nga kafiteritsë gjatë orës së mbrëmjes gjatë kohës së verës, ku do te duhej te ketë matësit e zhurmës. Kam një pyetje rreth të hyrave vetanake , ne mënyrë ligjore si është epilogu i saj?

Ganimete Qeriqi, tha se ka shume vite që ndaj punëtoreve të shërbimit emergjent në Lipjan ushtrohet një qëndrim diskret nga kompetentët, është krijuar një mendësi që këta punëtor duhet me u shfrytëzuar me u shtrydhur dhe me përfituar sa ma shumë në kohe. Dikur ky shërbim edhe ka me u rregulluar ama këta punëtorë i kanë djegur deri në piken zero. Mendoni shërbimet: Strehimorja në Lipjan, Qendra Azilit në Magure, Burgu i Lipjanit, Shtëpia e komuniteteve në Lipjan, Aksidentet në trafik Të gjitha vizitat shtëpiake të sëmurave kronik, gjitha qendrat tregtare klinikat universiteti e kërkojnë shërbimin nga emergjenca, shto kësaj edhe 200-250 vizita brenda objektit, me të gjitha shërbimet mjekësore brenda një orarit pa asnjë stimulim shtesë ose vetëm 5 euro, në ato kushte higjienike të mjerueshme ku mungon edhe elementi kryesor uji i pijshëm etj. ,kjo ngarkesë quhet djegëse totale e punëtorëve. Pse punëtorët shëndetësor të shërbimit emergjent duhet me dal në raste urgjente dhe përsëri brenda orarit me ju shërbyer edhe 200 pacienteve Në këso situatash kualiteti i punës është shkel e shko. Mirëpo për dike këtu ma i rëndësishëm është buxheti i komunës se shëndeti qytetarëve dhe shëndeti i punëtoreve. Emergjenca në Lipjan është shndërruar në zonë kalimtare kush kalon aty me marrë nga një injeksion për me flete natën me mire. Pjesëtoni të gjitha këto shërbime brenda natës në veç 3 e më shume 2 teknik atëherë del llogaria sa ngarkohet një punëtor i nderimit natës ne Lipjan, në kushte normale një shërbim i tillë do të ishte paguar dy fish. Kjo gjendje nuk e ndihmon shëndetin e qytetarëve. Komuna nuk bën me mbyll kuletën ,por duhet me bërë zgjidhje, Punëtorët janë duke pësuar dhunë sistematike kërkoj me u marrë masa ose ketë gjendje do ta adresoj në inspektorat shëndetësor.

Nexhmedin Lekiqi, tha se ne si Komitet për Shëndetësi e kemi raportin për mbledhjen e ardhshme dhe do të shihni përgjigjet për pyetjet që i betë për Shëndetësi për të mirat dhe sfidat që po përballet shëndetësia në Lipjan .

Diamant Bytyqi nënkryetar i komunës, tha se kujdesi paleativ është funksional që një kohë të gjatë, dhe punojnë nga ora 7 deri ne 15:00 dhe po e shohim

mundësinë që me punuar edhe gjate ditëve të vikendit, Për momentin i kemi vetëm 2 infermier po e shohim mundësinë me i bë 4 infermier. Në Gadime rruga “Imer Ukshini” është planifikuar por lënda është në OSHP, në Banullë rruga “Livadhet e Thata” kemi probleme pronësore. Te stadiumi Ulpiana para disa dite kemi intervenuar pasi që ka pas disa telashe me energji elektrike, por do të përfundoj se shpejti. Në Kraishtë lokacioni për varrosjen e kafshëve të ngordhura, aty është ndarë lokacioni nga Kuvendi ne vitin 2018, por nëse e shohim qe po shkakton telashe ne mund edhe ta ndryshojmë lokacionin, por nëse keni ju një propozim në mund ta ndryshojmë. Kampanjë vetëdijësuese jemi të gatshëm e sidomos për mbeturinat. Sa i përket tatimit në pronë ende është diskutuar në Qeveri. Por se bashku me Asociacionin e komunave jemi duke e diskutuar këtë çështje. Rregullorja për varrezat do ta shohim në të ardhëm si do te veprojmë. Prerja e betonit nga KESKO, po na shkakton probleme dhe shpesh here ne nuk po u epim leje për shkak se nuk po kthehen ne gjendjen e me pashme. Nëse nuk e kryen KESKO, e kryejmë ne, punën. Sa i përket rasteve sociale ne kemi kërkuar një listë nga QPS-ja, dhe i kemi mbështet rastet sociale. Sa i përket pilot projektit të shëndetësisë jemi duke u përgatitur edhe komuna jone , i cili projekt do të filloj në shtator. Zhurmuesit gjatë kohës së natës nga kafenetë po e shohim si po e bënë Prishtina, pastaj do ta bëjmë edhe ne.

Rinor Murati, tha se i kam dy kërkesa, e para sa i përket rrugës Hallaq Kraishtë rrugë është e dëmtuar, dhe sa herë kalojnë dy vetura duhet njëra te ndalet për shkak të rrugës së dëmtuar, intervenimi në atë pjesë është i domosdoshëm. Dhe e dyta te rruga “Zylfije Gashi” deri te Emergjenca është krijuar një kryqëzim dhe po shkaktohen aksidente është mirë të intervenohet në atë pjesë.

Shahadije Bikliqi, tha se çështja e parë është kërkesë e banorëve të fshatit Bukovicë për asfaltimin e rrugë së tyre. Pyetje e dyte, janë ndarë mjete për Janjevë për restaurimin e rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit, deri ku ka shkua ajo pjesë. Tjetra po e përsërit prapë shqetësimin e banorëve të Janjevës për transport publik. Dhe e fundit para disa ditëve me komitetin për Komunitete e kemi vizituar shkollën “Zenel Hjadini” në Gadime, dhe sipas drejtorit të shkollës e kanë braktisë shkollën 13 nxënës të komunitetit jo shumicë dhe komuna nuk është marrë hiç me këtë çështje.

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje për DKA-në, sa shkolla janë ta pasuara me mjete konkretizimi bashkëkohor dhe sa janë funksionale.

Herolind Kozhani, tha se i kam disa çështje për t'i ngritur, para rruga "Vehbi Kozhani" ne Ribar të Madh që e lidh rrugën për Zllakuqan, mirë shumë qe po rregullohet por punët nuk po kryhen si duhet dhe po shkojnë ngadalë , kam një pyetje ta dijë pse po ndodh një gjë e tillë. Ka një kontratë për pastrimin e varrezave, sa herë brenda një viti duhet te pastrohen varrezat sipas kësaj kontrate. Tjetra ujësjellësi për fshatrat e teritorin të Kraishtë e Ribar i Madh ka mbet në gjysme pse nuk po kryhet ai projekt. Sa i përket kujdesit paleativ, unë jam pjesë e atij ekipi dhe përbehet prej dy anëtarëve me pasëditë pune nga e hëna të premtën, por kërkohet që të kenë edhe disa kushte si veturë e të tjera.

Armend Grajqevci, tha se do ta ngris çështjen e tatimit në pronë ku sot është afati i fundit për pagesën e këstit të parë. Si do të bëhet ribursimi i këtyre mjete nga qeveria për komunat, pasi sipas qeverisë do të bëhte falja prej 100 euro për çdo qytetarë.

Fadil Spahiu, tha se Kërkesa e parë është për Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim: Duke u bazuar në përgjegjësit për kujdesin dhe funksionimin e ndriçimit publik, kërkoj nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim që të vendos një shtyllë të ndriçimit publik në fshatin Smallushë, rruga e shkollës, sepse në atë zonë pas dëmtimit të një shtylle të ndriçimit publik organet kompetente e kanë marruar shtyllën për ta zëvendësuar me një të re, mirëpo kanë kaluar disa muaj dhe ende nuk është bërë zëvendësimi i shtyllës. Pas zhvendosjes së shtyllës kabllot e energjisë elektrike kanë mbetur në trotuar edhe pse janë izoluar sipërfaqësisht ato po shkaktojnë rrezik për jetë, sepse nëpër atë trotuar përkatësisht ku ka qenë e vendosur shtylla kalojnë të gjithë nxënësit e fshatit dhe nga pakujdesia nxënësit mund t'i prekin dhe të rrezikojnë jetën e tyre dhe të tjerëve. Andaj i bëj thirrje Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim që sa më parë që është e mundur ta vendosë shtyllën e ndriçimit publik që të evitohet rreziku. Kërkesa e dytë është përsëri për Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim: Banorët e fshatit Grackë e Vogël, duke u bazuar në përgjegjësit për kujdesin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimit nga ana e Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, kanë bërë kërkesë që të rregullohet rrjeti i kanalizimit në fshatin Grackë e Vogël, në Lagjen e Mollapolcëve, Rruga "Martirët e 1912", sepse në këtë vendë është bllokuar kanalizimi më shumë se një muaj dhe ende nuk është bërë asnjë intervenim nga organet kompetente. Si pasojë e këtij bllokimi disa familje kanë filluar të çkyqen nga rrjeti sepse probleme të ngjashme ka pasur që nga shtrirja e këtij rrjeti të kanalizimit edhe pse kohë më parë janë bërë disa intervenime ende po vazhdon të ketë pengesa. Kërkesa e tretë është për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe

Sport: Para pak ditësh e pashë që në web sajtin e Komunës, është bërë një shpallje publike për një organizim i quajtur “MËRGATA FEST 2023” Verën e kaluar isha rastësisht prezent në këtë organizim që po mbahej në sheshin "Adem Jashari" dhe më bëri shumë përshtypje se si ky organizim kishte grumbulluar kaq shumë qytetarë e nga kureshtja u bashkova për pak, e mbeta për disa orë aty, pasi ishte shumë ndryshe nga organizimet tjera. Aty vërejta sporte të ndryshme diku rreth 10 sosh, ku nuk isha i njoftuar më herët për sporte të tilla kaq atraktive dhe që po priteshin me kaq entuziazëm dhe shumë kënaqësi nga publiku pjesëmarrës. Po ashtu kishte festival muzikor me këngëtarët e estradës dhe ku po shihej tek secili qytetar se sa mirë po pritej i gjithë ky organizim. Për 3 ditë rresht kishte gara në rreth 10 sporte të ndryshme dhe muzikë argëtuese për qytetarët, ku e gjithë kjo ishte pa biletë e pa pagesë për të ju bashkuar sporteve. Përtej argëtimit e garave në sporte, fituesit shpërbleheshin me mjete financiare në secilin sport. Edhe pse kishte publikë jashtëzakonisht shumë, mendoj që duhet të informohen qytetarët më herët për këtë eveniment pasi i gjithë ky organizim bëhet për ta, e sidomos për Mërgatën. Unë uroj dhe shpresoj që të vlerësohet pozitivisht nga ekzekutivi ky organizim kaq i veçantë dhe të bëhet si organizim tradicional! Ky është edhe mesazhi që ma dërguan disa qytetarë nga Mërgata.

Lulzim Rrustemi, tha se kam disa pyetje dhe kërkesa, e para ka të bëjë me ndërtimin e urës mbi lumin “Sitnica” te rruga “Marie Shllaku” a është ndërruar për këtë rrugë? E dyta a është bërë evidentimi i dëmeve në rrugën “Shefki Salihu” përball lumit “Janevka”. Është një kërkesë e rrugës “Martirët e Akllapit në lagjen e Akllapit , për asfaltim. Tjetra rruga “12 Qershori”, në Lagjën e Re, mungon ndriçimi publik. Po ashtu në këtë lagje ka probleme edhe me rrjetin e kanalizimit pasi që derdhen ujërat në livadhe dhe duhet të intervenohet. Tjetra, në ato pjese ku po dëmtohet asfalti nga kompani të ndryshme duhet të intervenohet dhe të rregullohet asfalti.

Besiana Sylja, tha se kam disa çështje, e para ka të bëjë me rrethojën në shkollën “Hasan Prishtina” ku janë bërë 3 vite që atje është vendosur vetëm bazamenti, por jo edhe rrethoja siç është planifikuar, po ashtu aty nuk ka as hapësira publike dhe kësaj duhet ti gjendet një zgjidhje. E dyta, në lagjen e Akllapit, ka 3 probleme; e para nuk ka emërtim, as kanalizim e as asfaltim. Dhe këta banorë kërkojnë që të ju bëhet një zgjidhje për çështjet e tyre.

Lumturije Bytyqi, tha se edhe unë do ta ngrisë shqetësimin e kompanive të cilat po shkaktoj dëme gjatë punimeve në rrugë, dhe duhet ato që të detyrojmë që ti kthejnë në gjendjen e më pashme rrugët të cilat po i dëmtojnë të gjobitet. Si komitet

për Komitete kemi vizituar shkollën “Zenel Hjadini” dhe kemi pa si po zhvillohet mësimi në atë shkollë, ishte për lëvdatë harmonia e bashkëjetesës, por shqetësuese ishte braktisja e mësimit nga 13 nxënës te komunitetit jo shumicë. Përkundër përpjekjes së drejtorisë ata nxënës nuk po kthehen në shkollë për shkak të kushteve financiare, edhe pse në mesin e tyre ka nxënës me sukses shumë të mirë. Unë kërkoj që të subvencionohen nxënësit që mësojnë mirë të këtyre komuniteteve në mënyrë që të profesionalizohen.

Nexhmedin Lekiqi, tha se rrallë po ka propozime me vend nga anëtarët e kuvendit me e përjashtim të disave. Në anëtarët e pozitës ngrisim shqetësime të qytetarëve po nuk është që i diskutojmë ato në kuvend dhe mos mendoni që nuk po kërkojmë asgjë për të mirën e qytetarëve.

Alban Salihu, tha se nuk është e vërtetë që unë e kam akuzuar komunë në Lipjanit, por kam thënë që KESKO, po ju akuzon juve vetëm kam kërkuar që komuna me gjet një zgjidhje. Tjetra kam kërkuar që komuna më e detyruar KESKON, që kur bën dëme me i riparuar ato.

Arsim Jashari, tha se në si PDK, kemi qen konstruktiv disa herë, sa i përket rrymës në disa ditë kemi mbet pa rrymë dhe kemi protestuar. Sa i përket lokacionit në Kraishtë jemi kundër pasi që është kundër kërkesave të qytetarëve.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se na nuk ja kemi dhënë pëlqimin KECIT, për shkak se kur po shkaktojnë dëme nuk po i kthejnë në gjendjen e mëparshme dhe kjo ka qenë si lloj vetëdijesimin. Dhe na jemi për çdo të mirë të qytetarëve. Na jemi te gatshëm me gjete një lokacion për deponite inerte dhe varrosjen e kafshëve, dhe ju gjene një lokacion të përshtatshëm në ju përkrahim. Në fshatin Bukovicë do të bëhet asfaltimi i rrugës së bashku me disa fshatra tjera. Te projekti i Janjevës kemi përfituar nga një projekt me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe do të kryhet shpejtë, ndërsa sa i përket transportit për Janjevë edhe aty do të kryhet pasi e kemi një pike tani në rend dite në bashkëpunim me komunën e Prishtinës. Rruga “Vehbi Kozhani” do të shtohet dinamika e punës por është projekt dy vjeçar. Varrezat do të pastrohen 2 herë në vit por edhe me kërkesë të menaxherit edhe më shpesh. Ujësjellësi është në bashkëpunim me CDI. Sa i përket tatimit në pronë asociacioni do të diskutojnë për faljen e borxhit se si ta bëjnë një zgjidhje. Ndriçimi në Smallushë do të kryhet shpejt, po ashtu edhe në Grackë kanalizimi do të fillon shpejtë. Sa i përket ures mbi lumin Sitnica te rruga “Marie Shllaku” nuk po e kryen punën kompania në fjalë por tani jemi duke e bërë një paramasë të re për atë urë. Sa i përket dëmeve rreth lumit Janjevaka nuk e kemi bërë ende një raport.

Rrethoja në LLugaxhi, ka dështuar ai projekt. Rruga në Lagjen e Akllapit do ta shohim mundësinë për ta kryer atje. Çdo kërkesë e anëtarëve të kuvendit e cila është e arsyeshme ne e marrim parasysh.

Rasim Hasani, tha se të gjitha shkollat janë të pajisura me internet llaptop, PC, dhe projektor. Nxënësit e komunitetit jo shumicë, ka probleme nga pak, por secila shkollë e ke të formuar ekipin e braktisjes se mësimi nga nxënësve. Po edhe ne mundohemi me i gjet zgjidhje çdo rasti. Ne kemi bërë kërkesë në Minsitri që nxënësit e komunitetit te Gadime ta kryejnë shkollë në Gadime mos te vijnë me bere shpenzime në Lipjan. Rrethojnë në fshatin Llugaxhi, është projekt 2 vjeçar. Ministria e Arsimit në Lipjan nuk ka asnjë projekt në Lipjan për 4 vite mandat.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 17 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 28 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 17-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Raporti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se një raport 3 mujor, dhe këtu shihet rrjedhja e parave dhe shpenzimet, dhe me dhëne një dinamikë të re për të ardhmen. Buxheti sipas fondeve burimore, kemi shpenzim të vogël të shpenzuar në kë periudhe mujore. Sipas kategorive ekonomike edhe këtu kemi një shpenzim shumë të vogël. Nga

granti Qeveritar pak më mirë, ndërsa nga të hyrat e bartura kemi shpenzim zero. Buxheti nga donatorët edhe këtu kemi zero shpenzim. Te investimet kapitale, nuk ka shpenzim te mirë, Te tatimi ne pronë jemi mirë. Kam një pyetje, te grumbullimi prej 200 mijë euro, si është pasi kemi një shpenzim te vogël.

Besiana Syla, tha se këtu në raport ende figuron buxhet i alokuar në vend që të jetë buxhet i miratuar, çka do me thënë se kjo nuk korrespondon me realitetin. Nga raporti qe po shihet kemi shpenzime shumë të vogla. Po ashtu edhe të granti qeveritar komuna e Lipjanit shumë mjete i ka humb pasi që i kanë shkuar suficit. Nëse e shikojmë me vitin e kaluar te tatimi në pronë, kemi me pak të hyra pse po ndodh kjo? Po ashtu komuna ka edhe shumë mjete që ju merren nga thesari.

Latif Ramadani, tha se te tatimi në pronë kemi rritje dhe i falënderojmë qytetarët për kontributin e dhënë. Kemi buxhet të alokuar. Bartje të hyrave do të bëhet edhe këtë vit.

Besiana Syla, tha se te buxheti i alokuar figuron buxhet i alokuar, pasi që të hyrat vetanake i keni alokuar , ndërsa te hyrat janë shumë të vogla. Te të hyrat vetanake kanë me të kthyer vetëm të vitit paraprak, jo të viteve me vonë.

Latif Ramadani, tha se qeveria e alokon mjetet. Te hyrat vetanake barten nuk humbin. Ne do ta shpenzojmë buxhetin ashtu siç e kemi planifikuar.

Arsim Jashari, tha se mjetet qe janë te mbetura i takojnë vetëm pushtetit komunal, qeveria nuk mundet me i bllokua mjetet.

Latif Ramadani, tha se ne kemi marrë vendim në kuvend për bartjen e të hyrave. Asnjë projekt i ri ne vitin 2023, nuk e kemi nga Qeveria e Kosovës.

Pastaj u dha pauzë nga Kryesuesi i mbledhjes nga ora 12:30 deri 13:45

III

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Momoramdu, bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “Qatar Charily”).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtori i DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ajo që është në të mirën e qytetarëve ne si grup i PDK-së do ta përkrahim. Dhe do ta votojmë këtë propozim vendim.

Alban Salihu, tha se ne e kemi diskutuar dhe ne KPF këtë pikë, por nuk e di a është themeluar ndonjë komision që e ka mbikëqyr se a janë duke i përdorur këta bujq këto mjete për bujqësi apo për diçka tjetër.

Rexhep Rexhepi, tha se këtë projekt e ka monitoruar vetëm Organizata Katari.

Alban Salihu, tha është dashtë që komunë me pas një monitorim se për çka po epen këto subvencione.

Rexhep Rexhepi, tha na e bëjmë monitorimin dhe e dalim ne teren së bashku me organizatën Katar. Qëllimi jon ka qenë që me përfituar fermerët dhe janë duke punuar ata që i kanë marr.

Diamant Bytyqi, tha se ne kemi bashkëpunim me Katarin dhe kryesisht kanë përfituar rastet sociale dhe ata që i kane kushtet më të rënda, dhe ne çdo subvencion të cilin e shpërndajmë edhe e mbikëqyrim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi Vendimin.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit tha kam një kërkesë që pika e 9-të e kuvendit të jetë e 4-ta me radhe për shkak të një agjende të drejtorit të kompanisë pastrimi.

IV

Informatë për raportin vjetor financiar 2022, të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave KPM "Pastrimi" Sh.A.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemit, ia kaloi fjalën Gazmend Rexhepit, drejtor i financave në kompaninë Pastrimi i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata?

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se kam një pyetje se çka do të bëhet me rastet sociale të cilët kanë borxhe. Nëse rastet sociale kanë borxhe kërkoj nga kompania pastrimi që ti liron nga borxhet këto raste nga pagesat dhe mos të procedohet te përmbaruesit privat por të ju gjendet një zgjidhje këtyre kategorive.

Gazmend Rexhepi, tha se trajtimi është kompetencë e komunave, dhe zgjidhje është te kuvendi komunal, Komuna e Prishtinës i paguan 100% faturat e pastrimit për të gjitha rastet.

Nexhmedin Lekiqi, tha se nëse kuvendi gjen mënyre që me ndihmuar kompaninë pastrimi, a do te fshihej i gjithë borxhi i këtyre familjeve për vitin kalendarik.

Alban Salihu, tha se ne media është thënë se po pritet te rritet fatura e kompanisë Pastrimi, me arsyetimin se është rritë çmimi i derivateve, mirëpo tani që ka ra çmimin i derivateve a do te jeni prapë i mendimit te rritet çmimi.

Ardit Cani, tha pasi që edhe Lipjani ka progres sa i përket pagesës se faturave, ne kemi kërkuar që të decentralizohemi, pasi që edhe Lipjani e meriton edhe me pas përqindje më të madhe të aksioneve ne kompaninë Pastrimi jo siç i kemi tani vetëm 10%

Besiana Sylja, tha se kompania pastrimi siç po shihet ka humbje të madhe, a është faktor kryesor inflacioni, apo ka ndonjë faktor tjetër.

Lulzim Rrustemi, tha se humbjet kaq të mëdha ne kompaninë Pastrimi janë shqetësuese, dhe nuk e di a ka ndonjë plan kompania Pastrimi, apo strategji si me i tejkaluar këto, pasi që klientëla është rritë në komunën e Lipjanit është një progres i mirë, ndërsa ne renditje me aksionar është e treta vetëm me 10 % të aksioneve. Kjo na jep pyetje, njësia operative ne Lipjan a ka mundësi me u pavarësuar dhe me i marr vet përgjegjësitë e veta. Pasi që qytetarët e Lipjanit janë ata që i paguajnë këto mjete dhe munda te ja dalim vet. Kompania pastrimi merr edhe tender nga komuna e Lipjanit dhe po shihet që kjo kompani Pastrimi nuk ka menaxhim të mirë. Njësia ne Lipjan ka kapacitete me u nda dhe me ecë vet edhe me mirë, e mos me mbet në borxhe.

Arsim Jashari, tha se më intereson marrëveshja që është tu e bërë Prishtina për skemat sociale. Po në si komunë nëse e bëjmë një gjë te tillë i bien që mbi 7 mijë euro mjete me i nda dhe se di a kemi të mundur me u mbuluar. Tjetra, po ashtu një sqarim në media flitet që ka aktakuza për stafin, a është e vërtetë kjo ose jo?

Gazmend Rexhepi, tha se sa i përket rasteve sociale na e kemi një marrëveshje me komunën e Prishtinës ku ajo i paguan te gjitha faturat e te gjithë qytetarët e komunës se Prishtinës. Faktor kryesor për rritje te çmimeve janë inflacioni e kryesisht rritja e çmimit të derivateve apo edhe pjesëve te makinerisë. Ne si kompani

jemi duke operuar me humbje. Po presim për këtë arsye që të rrisim çmimet me prag minimal 6 euro. Sa i përket decentralizimit jam për dhe është dashtë që të bëhet edhe me herët nga aksionarët dhe është shumë i domosdoshëm. Plan strategjik për momentin nuk kemi, Por po pritët rritja e faturave. Sa i përket rasteve në media, nuk munden me dhënë informacione. Po kemi vështirësi operative në përgjithësi.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit tha se qështja e përgjegjësie në qeverisje publike, e menaxhimit të mbeturinave është një ndër sfidat më të mëdha, e cila e parë në bazë të ligjeve në fuqi zhvillohet indirekt nga komunat si përgjegjësi. Ne në vazhdim do të kërkojmë decentralizimin financiar. Në Lipjan i kemi shpërnda mbi 12 mijë shporta dhe kemi shtuar numrin e konsumatorëve, Qështja e menaxhimit është nga Pastrimi. Na para dy vite e kemi adresu një kërkesë për me themelua një ndërmarrje publike e që do të kryente shumë shërbime dhe do të kishte shumë benifite. Dhe ne që 6 muaj nuk kemi marr asnjë përgjigje edhe pse kemi pas një takim me ministrinë. Ne mund ta menaxhojmë shumë mirë nëse do të jemi të decentralizuar. Nëse komuna ka ditë mi shërbye kësaj kompanie, mirëpo kompania ka përgjegjësi edhe ndaj familjeve me asistencë sociale, dhe ne nuk mund të marrim përgjegjësi për komunat tjera. Dhe ne si Lipjan jemi të gatshëm të kemi pavarësi financiare, dhe ne vet i ndalim në ndihme si komunë. Qytetarëve të Lipjanit e Komunës së Lipjanit i duhet një ndërmarrje të cilën e menaxhon vetë.

Arsim Jashari, tha se plotësisht jam dakord me juve kryetar dhe ne si grup i PDK-së, pajtohemi që të jemi të ndarë. Familjet prej vitit 2021 janë të stergarkuar dhe nëse edhe këtë tarifë nëse e rritim kjo do t'i dëmtonte shumë. Ne nuk e votojmë rritjen e këtij çmimi.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha unë kam kërkesë me shkrim për rritje të çmimit të faturës së mbeturinave dhe nuk e kam sjellë në kuvend dhe nuk do ta bij asnjëherë. Lipjani nuk do ta këtë në rend ditë rritjen e faturave të mbeturinave.

Gazmend Rexhepi, na kemi kërkesë për rritje të tarifave për shkak të rritjes së çmimeve, dhe nuk mund të ofrojmë shërbime cilësore me këto çmime, nëse nuk rritet tarifat.

Daut Azemi, shpresojmë që kjo informatë të shërbej edhe në rritjen e cilësisë së punës.

Pastaj u kalua në pikën në vijim?

IV

Propozim Vnedimi për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për Hyrje në bashkëpunim ndër-komunal.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit, drejtor i DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ne si grup i PDK-ë e përkrahim dhe jemi idhëtar të marrëveshjeve të tilla me komunat fqinje. Kjo marrëveshje shpresojmë që është bërë me një analizë të thellë për zgjidhjen e sa më shumë problemeve.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 1 abstenim aprovoi Vendim

V

Propozim Rregullore për orarin e punës të veprimtarive ekonomike në teritorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se ne grupi i PDK-së e kemi përkrah nga fillimi një rregullore të tillë, por unë kam dy propozime të neni 5 te super marketet, që të jetë ditë pushimi te dielen dhe të jeni dy super markete në Lipjan me rrotacion me orar te gjatë. Do të ishte mirë që të dilën asnjë market pas orës 14:00 mos te punoj.

Daut Azemi, kjo rregullore nuk përcakton orarin punëtoreve, e përcakton Ligji dhe në të ardhmen mund ta ndryshojmë.

Fitim Mëziu, tha se te neni 11, te ordinancat private, këto se pari e dërgojnë orarin në Ministri të Shëndetësisë, dhe këto punojnë sipas lejes së Ministrisë së Shëndetësisë. Mos po na kthen prap MAPL-ja, këtë rregullore.

Alban Salihu, tha se unë edhe ne KPF, propozova qe ato biznese të cilat punojnë me anëtarë te familjes te lejohen te punojnë. Edhe pse ndoshta pas një kohë me siguri të na duhet ta plotësojmë dhe ndryshojmë prap këtë rregullore. Ne e përkrahim këtë rregullore.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se unë qëndroj e mendimit se me këtë rregullore do të mbrohen të drejtat e punëtoreve, pasi që në festat ka punëtor që asnjëherë nuk pushojnë.

Shahadije Dragaçina, tha se te neni 7 pika 2.3 te sallonet e ondulimit te orari i punës kam propozim që të dielave të kenë një orar të caktuar sikurse dhe disa biznese tjera.

Arsim Jashari, tha se ka qen e nevojshme me pas një rregullore, dhe në të ardhmen mund të ndryshojmë plotësojmë në të ardhmen dhe e përkrahim si grup.

Herolind Kozhani, tha se te barnatoret te cilat nuk kanë pas orar të caktuar a do te keni orarin se sa do të punojnë, me vikende me ditë të punës.

Daut Azemi, tha kjo rregullore nuk është ideale dhe ne te ardhmen mund ta ndryshojmë. Shqetësuese është te kjo rregullore se shumë pak anëtar të kuvendit dhe biznese kanë marr pjesë në dëgjim publik.

Valon Pacolli, tha se ne ju kemi dërgu ftesa edhe anëtareve të kuvendit përmes sektorit të kuvendit që të marrin pjese në dëgjim publik për këtë rregullore, mirëpo nuk ka pasur interesim te anëtarëve të kuvendit dhe ne si komision jemi munduar që të marrim kërkesat me të cilat janë përballur komisioni në teren. Ne e kemi marrë edhe një konfirmim nga ministria e Tregtisë për këtë rregullore. Po nëse bjen në kundërshtim me ordinancat ne prap do ta dërgojmë në MAPL për konfirmim. Ndërsa barnatoret do të jenë me rotacion.

Fadil Sopa tha se ku qëndron problemi te rotacioni i marketëve pasi qe unë vetë kam kërkuar që të dielën marketet mos të punojnë. Pasi që të dielën prap po detyrohen me ardhë punëtori në punë me këtë rregullore.

Valon Pacolli, tha se problemi ka qenë me klasifikua se cili market apo cili super market me bërë me rrotacion.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se dita e dielë me qenë pushim duhet te jetë nga niveli qendror. Ne në të ardhëm mundemi prap me ndryshua aty ku e shohim te nevojshme.

Valon Pacolli, na kemi konsideruar qe sezone e verës ka punë me shumë për atë kemi lënë afatin pak me te gjatë

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, , aprovoi Rregulloren.

VI

Propozim Vendimi për zëvendësimin e antarës së Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2022-2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Egzona Bytyqi, tha se ne si grup i PDK-se, jemi pro këtij propozim vendimi?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime aprovoi Vendim

VII

Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se ju po e bëni një punë pa punë, është dashtë mos me ndryshua hiç. Dhe me këtë po bëni diskriminim ndaj këtyre studentëve, që studiojnë jashtë vendit. Sot komunikimi marrin për 5 minuta nga secili universitet i botës, tjetra kemi ambasada te Kosovës në të gjitha shtetet dhe mund të bëhet zgjidhje. Dhe ky kuadër 9 studentë nuk duhet të diskriminohen, por duhet të ju gjendet zgjidhje këtyre studentëve. Ne nuk do ta votojmë këtë rregullore.

Rinor Murati, tha se unë personalisht jam angazhuar për këta student dhe kemi pas një takim me kryetarin së bashku me drejtoreshën e kulturës, dhe e kemi

diskutuar për këtë rregullore. Ne si grup e mbështesim këtë rregullore. Presim që të ju ndihmohet në ndonjë mënyrë këtyre studenteve.

Egzona Bytyqi, tha se në e diskutuam edhe në KPF, për këtë propozim rregullore, por kam një pyetje sa ka qenë numri i përfituesve që kanë fituar bursë me automatizëm. A është pagesë vetëm aspekti ligjor për ju nda bursa studenteve të studimeve posdiplomatike master dhe doktoraturë.

Alban Salihu, tha se ka pas mundësi me i ndihmua edhe këta studentë. Por argumentet e anëtarit të kuvendit na binden që edhe në të votojmë kundër kësaj rregullore.

Rasim Hasani, tha se kjo rregullore ka qenë në debat publik dhe nuk ka pas interesim nga askush për këtë dhe tash me thane jemi ardhëm në situatë konfuze nuk është e drejtë. Komisioni nuk e ka mundet me i ndjek ambasadat për secilin studentë, pasi që edhe komisioni e ka një afat ligjor. Dhe në si komunë nuk duhet me leju me aplikua student që studiojnë jashtë dhe mos me ju dhënë bursë. Me automatizëm kemi një student.

Arsim Jashari tha se ti kemi ligjet e rregulloret që çdo studentë që studion jashtë vendit të ketë të drejtën të aplikoj për bursë në vendin tonë pavarësisht kriterëve.

Diamant Bytyqi tha se për shkak të mos realizimit nga komisioni duke u bazuar në këtë rregullore dëshira vullneti dhe gatishmëria kanë qenë e kryetarit që t'i mbështes pavarësisht partisë, për mendimin time është që do të jete vlerë e shtuar e komunës tonë që në të ardhmen këta student do të kontribuojnë qytetit tonë, duhet t'i mbështesim sepse është nevojë t'i mbështesim me këto subvencione

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 7 kundër dhe 2 abstenim aprovoi Vendim

VIII

Propozim Vendimi për zëvendësimin e antarës së Kshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- KKSB-së.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se për neve është kënaqësi te votojmë për anëtar të KKSB-së një njeri me virtyte te larta e me përvojë të madhe siç është Hasna Luma.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, aprovoi Vendimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:15.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi